



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2373

NR. VENDIMI 841

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Nr. 2373 Akti

Nr. 841

Vendimi

Dt.30.08.2017

DT.05.02.2018

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, E PËRBËRË NGA:
ENEIDA CIVICI – GJYQTARE

Asistuar nga sekretare gjyqësore Anjeza Nergjoni, sot më datë 05.02.2018, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me Nr.2373 akti, që i përket:

PADITËS: Shoqëria “***”, me seli në ***, përfaqësuar në gjykim nga juristi ***.

I PADITUR: Shoqëria “***”, me adresë ***, përfaqësuar në gjykim në bazë të autorizimit date ***nga Av. ***. (I papranishëm në shpallje vendimi).

- OBJEKTI:** 1) Ndalimin e veprimeve të palës së paditur në shkelje të të drejtave të përfituara me rregjistrimin e markës me nr rregjistrimi *** pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe mospërsëritjen në të ardhmen.
- 2) Heqjen e sasisë së produktit ujë të hedhur në treg prej palës së paditur me ambalazh në shkelje të të drejtave të përfituara me rregjistrimin e markës me nr rregjistrimi *** pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave.
- 3) Publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në dy televizione kombëtare me shpenzimet e të paditurit që ka kryer shkeljen, në mënyrën e parashikuar nga gjykata.

BAZA LIGJORE: Ligji nr.9947 datë 07.07.2008 “Për pronësinë industriale”,(Ndryshuar me ligjin nr.10/2013 datë 14.02.2013) neni 156, 167 nenet 32 e vijues të K.Pr.Civile, 608, 640 TË K.Civil.

Në përfundim të gjykimit palët kërkuar:

Paditësi kërkoi: Pranimin e padisë.

I padituri: Rrëzimin e padisë.

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështje, pasi shqyrtoi provat e paraqitura në gjykim, dëgjoji palët dhe analizoi çështjen në tërësi

V Ë R E N

Çështja i përket juridiksionit gjyqësor dhe gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është kompetente për shqyrtimin e saj.

Rrethanat e faktit:

Pala paditëse shoqëria "**" sh.a është një person juridik i rregjistruar në vitin 1999, me objekt të veprimtarisë prodhim ambalazhim tregëtim uji natyral.**

Pala e paditur shoqëria "**" sh.p.k është një person juridik i rregjistruar në vitin 2010, me objekt të veprimtarisë prodhim ambalazhim tregëtim uji natyral.**

Sipas çertifikatës të rregjistrimit të markës të lëshuar prej DPPM-së nr.* datë 10.04.2015, e rinovuar me certifikatën datë 20.07.2017 nr.*** (çertifikata e fundit e paditësit) rezulton se nëpërmjet saj mbrohen ngjyrat e markës. Konkretisht ato janë blu, e bardhë dhe gri. Marka e rregjistruar në disanj pasqyron një mal me tre kreshta të mprehta, me bazë të ngushtë, të bardha në majë, të evidentuara në të djathtë të pamjes, me mbishkrimin sipër pamjes "****".**

Në bazë të kësaj marke dhe logoje rezulton se paditësi ka notifikuar dhe etiketat që përmbajë ngjyrat e mbrojtura dhe ngjyrën jeshile si dhe logon e rregjistruar në vitin 2015.

Pala e paditur sipas çertifikatës së rregjistrimit të markës që paraqiti në gjykim nr.* datë 22.02.2017 ka të mbrojtur nëpërmjet saj ngjyrat blu, e bardhë dhe bojëqielli.**

Marka e rregjistruar në disanj pasqyron një mal me disa kreshta me bazë të gjerë, të evidentuara katër të tilla në të majtë të pamjes dhe me ngjyrë blu me pak të bardhë në disa pjesë. Mbi të shkruhet dhe "**" "****" ***.**

Pala e paditur shoqëria "**"sh.p.k sipas kërkesës 30.01.2017 ka notifikuar etiketat pranë AKU Shkodër në datë 06.02.2017, ku për ambalazhimet 0,5 litër dhe ato 1,5 litër etiketat janë ndryshe nga ambalazhimet 7 L dhe 19L. Etiketat e dy ambalazhimeve 7 L dhe 19L janë sipas logos dhe disenjos dhe ngjyrave të markës.**

Në datë 13.10.2017 pala e paditur ka paraqitur një kërkesë të re pranë AKU Shkodër për notifikim etikete ku për të gjitha ambalazhimet 0,5 litër, 1,5 litër, 7 L dhe 19L etiketat janë njësoj dhe sipas logos përfaqësuese të markës përsa i përket dhe ngjyrave dhe disanjit të logos.

Pretendimet e palëve:

Paditësi pretendoi se: Pala e paditur ka kopjuar etiketat e paditësit në ambalazhet e saj 0,5 L dhe 1,5 L duke shkeluar të drejtat e markës të mbrojtura me ligj. Ai pretendoi se nëpërmjet këtij veprimi i padituri ka krijuar konfuzion në treg në kushtet kur vendodhja e stabilimentit të kompanisë "**" sh.a dhe punishtes së kompanisë "****" sh.p.k janë në të njëjtën komunë sipas ndarjes së vjetër administrative. Shoqëria tregtare "****" sh.a është cenuar në interesat e saj, nga veprimet e paligjshme të pales së paditur, edhe konsumatori nuk ka mundur të zgjedhë lirshëm, pa u ngaterruar, atë produkt që ai vlerëson si çilesor, atë produkt që dëshiron të konsumojë. Produkti perfundimtar i kompanisë *** sh.a. është i çilesisë Premium, nderkohe që cenohet nga një produkt i kufizuar. Pala paditëse është markë e mirënjohur në treg e cila shpenzon shumë për reklamimin e produkteve të saj.**

I padituri pretendoi se: Për sa i përket pamjes vizuale të etiketes, pamje e cila kontestohet nga pala paditëse, pala e paditur me kërkesën e datës 13.10.2017 "Kërkesë për notifikim etikete" drejtuar AKU Shkodër, ka kërkuar notifikimin e etiketave të reja, të disa prej produkteve që tregton. Konkretisht ujë natyral me peshë 0,5, 1,5 L, 7l si dhe ambalazhit 19L që nuk ka ndryshuar nga ai fillestar. Fakti që etiketat janë të ndryshme për ambalazhe të ndryshme në asnjë lloj forme nuk provon pretendimin e paditësit se ky veprim

ka patur qellime dashakeqe ndaj tij. Etiketat jane te ndryshme per keto ambalazhime per shkak te permasave te ambalazheve si dhe te formës të zgjedhur prej marketingut dhe ideatoreve te saj, me qellim promovimin e ketyre lloj ambalazheve ku përmasat 7L dhe 19 L jane konsideruar edhe me te suksesshmet e kesaj shoqerie. Ne kërkesën ndryshimin e etiketave të datës 13.10.2017 e kemi bërë në mënyrë krejt spontane ende pa na u komunikuar padia me qëllim rinovimin e imazhit të kompanisë e cila është në rritje. Sot ajo ka një imazh krejt tjetër në treg duke humbur kuptimin padia.

Në përfundim të analizën e faktit dhe të ligjit, gjykata do të mbajë në konsideratë nenin 16 të Kodit te Proçedurës Civile, I cili parashikon se gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të bëjnë palët.

Në vendimin unifikues Nr.9 datë 09.03.2006 Gjykata e Lartë ka unifikuar praktikën se gjykata është e detyruar që të bëjë cilësimin e saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, por pa ndryshuar bazën ligjore të padisë e cila është vetëm në disponim të paditësit.

Në vendimin nr.3 datë 29.03.2012 Gjykata e Lartë ka unifikuar praktikën se: Në këtë kuptim, gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj. Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojtë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cënuar.”

Pra gjykata ka detyrimin ligjor të mos I referohet bazës ligjore të padisë së paditësit I cili mund ta referojë atë dhe gabim por të zbulojë nga kërkesë padia të drejtën që paditësi kërkon të mbrojtë duke përcaktuar drejt shkakun ligjor të padisë nga faktet e ngjara dhe të drejtat e cënuara.

Referuar pretendimeve dhe prapësimeve të paraqitura nga palët gjykata çmon se:

Neni 140 i ligjit 9947 datë 07.07.2008 i ndryshuar parashikon se: “Shenjat që mund të përbëjnë markë”

Një markë mund të jetë çdo shenjë, në veçanti fjalët, duke përfshirë emrat personalë ose disenjimet, shkronjat, numrat, ngjyrat, formën e mallrave ose të paketimeve të tyre ose tingujt, me kusht që këto shenja të jenë të afta:

- a) të dallojnë mallrat apo shërbimet e një personi fizik apo juridik nga ato të një personi tjetër fizik apo juridik;
- b) të përfaqësohen në regjistër në mënyrë të tillë, që të mundësojnë autoritetet kompetente dhe publikun të përcaktojnë qartë dhe saktë objektin e mbrojtjes që i njihet pronarit të saj.”.

Neni 145 i ligjit 9947 datë 07.07.2008 i ndryshuar parashikon se: “ 1. Kërkesa për të fituar të drejtën mbi një markë mund të bëhet nga çdo person.2. Për çdo shenjë, për të cilën kërkohet mbrojtja si markë, duhet të bëhet kërkesë e veçantë. 3. Kërkesa për të regjistruar një markë përmban një ose disa klasa mallrash dhe/ose shërbimesh.

4.Kërkesa për regjistrimin e një marke përmban elementet e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e aplikantit;

b) përfaqësimin (pamjen) e markës, për të cilën kërkohet regjistrimi;”

Pala paditëse nëpërmjet padisë së saj pretendon se i padituri në produktet e ujit 0,5 L dhe 1,5 L ka vendosur etiketa me pamje të cilat paditesi i mbron nëpërmjet markës së tij.

Gjykata çmon se referuar çertificates markës nr. * rregjistrimi të palës paditëse të rregjistruar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, konkretisht në pjesën elementët e mbrojtur dhe Përfaqësimi i Markës (pamja) dhe etiketave të amaballazheve 0,5 L dhe 1,5 L të hedhura në treg nga i padituri dhe të notifikuar nga AKU Shkodër sipas kërkesës së datës 30.01.2017, në fakt përmbajnë në mënyrë të dukshme disa elemente që paditësi i ka të rregjistruara në markë dhe konkretisht:**

a. Forma e maleve (disenjoja e tyre) në markën e rregjistruar nga paditësi, është e njëjtë me formën e maleve që i padituri shoqëria “**”sh.p.k, ka vendosur në etiketën e notifikuar në datë 06.02.2017 në AKU Shkodër sipas kërkesës datë 30.01.2017 për ambalazhet 0,5 dhe 1,5 litër. Ajo është e njëjtë si për nga forma ashtu dhe për nga sasia e kreshtave në to dhe thyerja e tyre duke i ndryshuar vetëm pjesa e ngjyrosur ku në etiketat e të paditurit malet janë bërë të bardha, ndërsa paditësi sipas markës dhe etiketave i ka të bardhë më të zezë.**

b. Ngjyrat e përdorura nga të dy palët ndërgjyqëse në këto ambalazhime pra 0,5 L dhe 1,5 L janë e bardhë, blu, jeshile, gri ndërkohë që ngjyrat që i padituri shoqëria “**”sh.p.k ka të mbrojtur sipas çertificates së DPPM-së janë blu (shumë e ndryshme nga ajo e etiketës) e bardhë dhe bojëqielli.**

Gjykata çmon se në fakt në pamje të parë këto etiketa të japin të njëjtin impresion për shkak të disenjos së njëjtë të maleve dhe ngjyrave shumë të përafërta duke i parë ato me një kujdes të zakonshëm. Gjykata vëren se disenjoja e maleve e mbrojtur nga paditësi me rregjistrimin e markës është e njëjtë me atë të etiketave të përdorura nga i padituri në ambalazhet 0,5 dhe 1,5 litër. Gjykata vëren se pavarësisht se emri është një element dallues në këto dy etiketa, përsëri tërësia e elementëve referuar dhe faktit që të dyja këto kompani tregëtojnë ujë që i përket të njëjtës zonë të territorit të Republikës së Shqipërisë, konkretisht * lehtësisht tek konsumatori mund të krijohet konfuzion.**

Kodi Civil ka përcaktuar elementet për të garantuar mbrojtjen ligjore të shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, dhe në nenin 638 në të cilin parashikohet se: parashikon se, “veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: (i) përdor emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërrësë me emrat dhe shënjat dalluese të përdorura ligjërisht nga të tjerë, ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; (ii) trajton si të vetat cilësitë e produkteve ose të ndërmarrjes së konkurrentit; (iii) përdor vetë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi çdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit”.

Për më tepër, neni 639 parashikon se: “Vendimi që vërteton veprime të konkurrencës së pandershme ndalon vazhdimin e tyre dhe përcakton masat e nevojshme me qëllim që të zhduken pasojat. Në qoftë se këto veprime janë kryer me faj, personi që i ka kryer detyrohet të shpërblejë dëmin”.

Gjykata çmon se në gjykim u provua, se pala e paditur jo vetëm që ka përdorur etiketa

për ambalazhimet e tij 0,5 L dhe 1,5 L me elementë të disanjit dhe ngjyrave të ndryshme nga marka e vet e rregjistruar, por këto etiketa kanë elementë të njëjtë dhe të përafërt me elementët e markës së rregjistruar nga paditësi. Gjykata çmon se u provua në gjykim ekzistenca e ngjashmerive të etiketave në ambalazhimet e produkteve të ujit 0,5 L dhe 1,5 L dhe ky fakt nuk u prapësua as nga vetë i padituri. Referuar shpjegimeve të dhëna në gjykim por dhe pretendimeve përfundimtare rezultoi se vetë i padituri nuk prapësoi në asnjë moment ngjashmërinë dhe përdorimin e këtyre elementëve të markës së paditësit, porse shpjegoi se kjo s'është kryer më dashje apo dashakeqësi pasi kjo diseno ishte zgjedhur prej ideatorëve të saj. Pra në themel ai pranoi përdorimin e etiketave të ngjashme.

Gjykata vëren se nuk është i vërtetë pretendimi i të paditurit se ai kërkesën ndryshimin e etiketave të datës 13.10.2017 për ambalazhet 0,5 L dhe 1,5 L, e ka bërë në mënyrë krejt spontane ende pa na u komunikuar padia me qëllim rinovimin e imazhit të kompanisë e cila është në rritje.

Provohet lehtësisht se pala e paditur ka marrë dijeni për padinë e paraqitur nga paditësi, me fletëthirrjen e datës 08.09.2017 komunikuar në datë 16.09.2017 sipas shënimit të kryer në fletëthirrje ku bashkangjitur saj ka qenë dhe padia, ndërkohë që kërkesa për notifikimin e etiketave të reja pranë AKUS-së Shkodër mban datën 13.10.2017 protokolluar në datë 14.11.2017 pranë AKU Shkodër. Për rrjedhojë kërkesa është kryer pas marrjes dijeni për gjykimin.

Gjykata vëren se në rastin konkret nuk u provua kryerja me dashje e shkeljeve të të drejtës së pronësisë industriale të paditësit të mbrojtura me rregjistrimin e markës, porse u provua ekzistenca e kësaj shkelje jo vetëm nga provat por dhe nga qëndrimi i vetë të paditurit i cili nuk prapësoi në asnjë moment këtë ngjashmëri madje ka ndër marrë veprime për të rregulluar këtë fakt, dhe kjo shkelje krijon konfuzion të konsumatori duke kryer konkurrencë të pandershme.

I padituri prapësoi në gjykim se padisë i ka rënë aktualiteti pasi ai ka notifikuar etiketa të reja dhe në treg nuk ka më mall me etiketat që kundërshtohen nga paditësi, pra nuk ka më shkelje të markës.

Gjykata vëren se është e vërtetë që në gjykim u paraqitën kërkesat për notifikim etikete dhe shkresa datë 17.11.2017 e AKUS-së Shkodër që e provon këtë, porse ky fakt nuk vërteton se në treg ende nuk ka ende sasi uji në ambalazh 0,5L dhe 1,5 L, me etiketat e mëparshme. Gjykata vëren se vetë i padituri prapësoi se ndryshimet i ka kryer në kuadër të rritjes së imazhit dhe cilësisë së produktit të vet në treg, pra për rrjedhojë ai pranoi se është një kompani në rritje duke mos mohuar faktin e pretenduar nga paditësi se ky i fundit është markë e mirrënjohur që ka vite që operon në treg duke tregtuar dhe produkt të cilësisë Premium. Për rrjedhojë rreziku i konfuzionit nga konsumatori mesatar intensifikohet edhe për arsye të famës së markës “****” e cila, gëzon statusin e markës së mirënjohur. Gjykata çmon se sa më e lartë është shkalla e njohjes së një marke aq më të rrepta janë kushtet që vendosen për përjashtimin e rrezikut për konfuzion sidomos kur malli i tregtuar është i njëjtë dhe “Ujë” dhe nga ë njëjta njësi e Shqipërisë konkretisht “****”.

Gjykata vëren gjithashtu se nuk gjejnë vend prapësimet e të paditurit se ata janë markë e rregjistruar dhe paditësi nuk ka kundërshtuar rregjistrimin sipas afateve ligjore, pasi shkelja e pretenduar nga paditësi nuk ka lidhje me markën e rregjistruar nga i padituri. Pra nuk ishte objekt i gjykimit nuk ishte shfuqizimi i markës së të paditurit

apo konstatimi i rregjistrimit të markës së tij në shkelje të të drejtave të fituara nga paditësi me markën e rregjistruar prej tij.

Paditësi nuk pretendoi në gjykim se marka e rregjistruar nga paditësi përben shkeljeve të markës të rregjistruar më parë prej tij. Ai pretendoi sikundër dhe u provua në gjykim se i padituri në kundërshtim me markën e rregjistruar prej tij, ka hedhur në treg një produkt ujë i ambalazhuar 0,5L dhe 1,5L me etiketa të cilat përmbajnë elementë të markës së paditësit, duke shkelur të drejtat e markës së paditësit dhe duke krijuar konkurrencë të pandershme.

Nisur nga sa më sipër gjykata çmon se padia duhet të pranohet bazuar në prova dhe në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 476 të K.Civil dhe 306 e vijues të K.Pr.Civile,

VENDOSI

Pranimin e kërkesë-padisë.

Pushimin e cënimit të të drejtave të pronësisë industriale nëpërmjet ndalimit të të paditurit shoqëria “****” sh.p.k, që të përdorë etiketat e notifikuara prej AKU-së sipas kërkesave të datës 30.01.2017 për të gjitha produktet e ujit 0,5 L dhe 1,5 L, pasi përben shkelje të të drejtave të përfituara nga paditësi me rregjistrimin e markës nr. *** rregjistrimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave dhe mospërsëritjen në të ardhmen.

Heqjen e sasisë së produktit ujë të hedhur në treg, prej palës së paditur me etiketat e notifikuara prej AKU-së sipas kërkesave të datës 30.01.2017 për të gjitha produktet e ujit 0,5 L dhe 1,5 L.

Publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në dy televizione kombëtare, me shpenzimet e të paditurit.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes. Për palën e papranishme ky afat fillon nga dita e nesërme e marrjes dijani.

U shpall në Tiranë sot më datë 05.02.2018.

Sekretare

Gjyqtare

Anjeza Nergjoni

Eneida

Civici

Shpenzime gjyqësore
Taksë gjyqësore ***Lekë
Fletëthirrje ***Lekë
Sekretare gjyqësore
Anjeza Nergjoni